



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

TIPOLOGJIA E NDËRTIMIT TË SHTËPISË NË TREVËN E PËRMETIT

Teuta Bajo*

Departamenti i Art- Dizajn. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,

Albanian University

Abstrakt

Në këtë punim fokusi drejtohet në tipologjinë e ndërtimit të shtëpisë¹, vendit ku jeton familja, të cilës i kushtohet një vëmendje e veçantë në mënyrën e jetesës dhe është një tregues i rëndësishëm në kulturën e një populli. Ajo së bashku me veshjen dhe ushqimin e ndjek njeriun si bashkudhëtarë në jetën e tij nga dita e parë që vjen në jetë deri sa ai përcillet për në “*banesën e fundit*”. E parë në këtë këndvështrim për studiues të ndryshëm, antropologë/ etnologë shtëpia mbetet dëshmi historike dhe kulturore, për çdo popull dhe merr kuptime të shumëfishta. Ndryshimet metaforike të ‘*shtëpisë ka[në] krijuar konceptin e kulturës si një artefakt shpirtëror, përmes së cilës njeriu rritet, edukohet, krijon dhe krijohet*’ (Canolli 2018).

Dëshmitë historike e kulturore, të arritura në ditët tona e që datojnë shumë herët, tregojnë për një larmishmëri të madhe në gjinitë e trashëgimisë sonë të ndërtimit. Ndërtimet e fortifikuara, të kultit (pagan, kristian e islamik), ato inxhinierike (ura, çezma, rrugë) arkitektura e ndërtimit të banesës dhe dekoracioni i tyre, në të gjithë territoret shqiptare², gjatë rrugëtimit të zhvillimit historik nxjerrin në dukje vlera kulturore me rëndësi studimore.

Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar ekspeditat e zhvilluara në terren në trevën e Përmetit, një hapësirë territoriale e shtrirë në të dyja anët e rrjedhjes së lumit Vjosë. Në klasifikimin tipologjik të shtëpisë luajnë rol faktorë të shumtë të cilët ndikojnë në ndërtimin e saj. Ndonëse tipi i shtëpisë elbasanase është më i përhapur në të gjithë trevën, duke u nisur nga karakteri individual i ndërtimit të shtëpisë në krahina të ndryshme vihen re edhe tipe të tjera banimi. Këtu do të veçojmë tre tipe ndërtesash: *me një kthinë, tipit koblarë³ dhe me dy kate me qemer*.

Fjalë kyçe: *shtëpia, ndërtimtari, trashëgimi ndërtimi, tipologji.*

Hyrje

Trashëgimia jonë ndërtimore, është e pasur për nga arritjet dhe e larmishme për nga gjinitë, me shtrirje të gjatë kohore, që daton shumë herët e arrin deri në ditët tona. Gjini të tilla si, **arkitektura popullore, ndërtimet e kultit** (pagane, kristiane e myslimane), ato **inxhinierike**, ndërtimet **fortifikuese** etj., pavarësisht funksionit, karakterit, dhe shkallës së zhvillimit të tyre, nga njëra anë lidhen

1 Në Shqipërinë e jugut është përdorur më tepër termi shtëpi sesa banesë.

2 Me këtë nënkuptojmë territoret në Shqipëri, Kosovën, trevat shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi e në Çamëri (Greqi).

3 Shtëpitë e këtij tipi janë ndërtuar nga mjeshtrit e fshatit Koblarë dhe gjejnë një përhapje të gjerë gjatë fillimit të shekullit XX.

me teknologjinë dhe materialet e reja të përdorur për ndërtimin. Ndësa nga ana tjetër mbartin tipare individuale me nota të veçanta si krijimtari, dhe identifikojnë traditën e ndërtimtarisë të lidhur me trojet e banuara nga shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve aktual të Shqipërisë.

Fillesat e ndërtimit të shtëpisë lidhen me kohën kur njeriu filloi të bëjë jetë sedentare të organizuar në vendbanime të ngulitura. Sipas antropologut amerikan Jerry Moore⁴ jeta sedentare u praktikua “kur buka dhe ushqimi i njeriut filloi të ruhej në një vend ose mjetet e nevojshme për përgatitjen e këtij ushqimi ishin të rënda për t’u bartur nga një vend në tjetrin” (2012). Si rrjedhojë e faktorëve klimatik, ekonomik, shoqëror, gjeografikë etj. ndryshoi edhe koncepti i tipologjisë së ndërtimit të shtëpisë.

Në kultura të ndryshme fjala shtëpi lidhet me banesën si koncept material por edhe me aspektin shpirtëror. Ndër shqiptarë koncepti *shtëpi*, apo edhe emërtimet e tjera që ndeshim, mbart në vetvete dy kuptime: *së pari*, shtëpia (vatra, zjarri, oxhaku) identifikohet me familjen dhe anëtarët e saj si një bashkësi shoqërore me lidhje gjaku. Shtëpia e ka lidhur fisin në rituale⁵, dhe si e tillë humbja e saj apo të qenit pa shtëpi ishte një turp, sepse është konsideruar si largim nga lidhja e gjakut dhe e të parëve. Në këtë kuptim nocioni shtëpi thekson ndjenjën e rrënjës brenda një trangu familjar. *Së dyti*, shtëpia merr kuptimin material, vendi a territori ku ndërtohet një objekt në të cilin do të banojnë pjesëtarët e familjes, por me zgjerimin e familjes edhe ngritjen e një strehe për familjen e re. Me kohë koncepti i parë ka zëvendësuar të dytin, sot koncepti shtëpi merr kuptimin më tepër të banesës si objekt, i cili duhet të sigurohet për t’u strehuar familja. Në këndvështrimin tim shihet një lidhje e ngushtë mes koncepteve, shtëpi-banesë, e cila mbart familjen si qelizën bazë të shoqërisë, nga ku rrjedh krijimi i trinomit, shtëpi-familje-banesë. Ky trinom së bashku me veshjen dhe ushqimin si bashkudhëtar i njeriut janë pjesë e mënyrës së jetesës që mbartin dëshmi historike dhe përbëjnë një ndër treguesit kulturor.

Karakteristikat e ndërtimit të shtëpisë tek shqiptarët

Studimet e deri tanishme mbi ndërtimtarinë tradicionale shqiptare tregojnë se cilindo shembull të ndërtimit të shtëpisë, të realizuar në fshat a në qytet, e karakterizon zgjidhja logjike për kohën kur ajo është ndërtuar, si dhe **mungesa e një projekti të hedhur më parë në letër**. Kjo nuk do të thotë se ndërtimi i shtëpisë është realizim krejt në mënyrë spontane. Përpara se të ndërtohej shtëpia studiohej mirë vendi dhe pozicioni ku do të ngrihej. Porositësi i shtëpisë, nga ana e tij, mund të përdorë si bazë nisjeje ndonjë banesë ekzistuese të familjes, ndonjë tjetër në fshat apo qytet me elemente të shumë arkitektonik. Kërkesat e parashtruara për lartësinë e shtëpisë, numrin e ambienteve, elementeve të zbulurimit etj. varej nga mundësia ekonomike e porositësit të cilat merreshin parasysh gjithmonë nga ndërtuesit. Këto kërkesa përbënin në thelb, atë që specialistët në gjuhën e tyre e quanin programin e banesës së ardhshme. Këtu hidhet pyetja: Ku qëndronte lidhja e ndërsjellët midis porositësit dhe mjeshtrit ndërtues kur nuk ekzistonte një program a planimetri e mëparshme? Në thelb vet “*ky program, ... i pa hedhur në letër, i pa shkruar, ka në sfond të paktën dy anë të lidhura e të ndërthurura me njëra-tjetrën. Së pari, lidhjen organike me truallin apo me mjedisin ku do të jetonte familja që po ngrinte shtëpi të re. [Pikërisht] aty, në atë ambient do të niste e do të merrte formë oborri i banimit të saj. [Së dyti], pozicioni i vendosjes [së banesës ishte puna e ndërtuesit dhe] zgjidhej i tillë që të lehtësonte lidhjen me zonat ekonomike të familjes (si ara, kullota, burime të ujit), por dhe me fshatin (si rrugë) etj.....*” (Muka 2010). Këtu qëndron zanafilla e shprehjes së lidhjes së ndërsjellë midis mjeshtrit ndërtues e pronarit të shtëpisë që do të ngrihej.

Lidhja e ndërsjellët nënkuptonte mirëkuptimin e të dy palëve gjatë gjithë procesit, ku porositësi e mjeshtri ndërtues qëndronin pranë njëri-tjetrit. Mjeshtri merrte në konsideratë kërkesat e porositësit dhe fuste në veprim përvojën e vet ndërtuese. Roli i porositësit merrte rëndësi, përveç në paracaktimin e truallit të ndërtimit, dhe në probleme të karakterit funksional (numri e përmasat e kateve, të kthinave,

4 Moore, Jerry D.. (2012) *The Prehistory of Home*, University of California Press.

5 Carsten, J. (2003) *After kinship*. Cambridge: University Press.

formulimi e pozicioni i vendosjes në raport me njëra- tjetrën). Ndërsa për probleme të karakterit të ngushtë teknik, kjo përparësi i kalonte mjeshtrit ndërtues.

Një tjetër karakteristikë e ndërtimtarisë popullore ishte se **mjeshtrit ndërtues nuk ishin të shkolluar dhe me diplomë**. Të ashtuquajturën diplomë ata e përfituan bazuar në intuitë e në përvojën e trashëguar nga babai tek djali, e kështu me radhë brez pas brezi. Prej kalimit të përvojës ndër breza morën diplomën e tyre shumë realizime të tipit të banesës që identifikoheshin me emrat e mjeshtrave të një zone të caktuar, të cila ndikojnë edhe në klasifikimin e tipologjisë së banesës.

Në përcaktimin dhe klasifikimin tipologjik të banesës janë njohur faktorë të ndryshmit të bazuar në kriterin: **gjeografik** (*relievit fushor, kordinor, malor, lugina etj.*) **por edhe krahinor**; me **karakter teknik**: *materiali dhe teknika në ngritjen e mureve; lartësia (përdhese, me një ose dy kate); mbulesë e çatisë (struktura mbajtëse, forma e jashtme e saj, numri i flegrave kulluese, materiali i përdorur; numrit të kthinave të banimit apo planimetrisë*. Krahas këtyre faktorëve teknikë në përcaktimin e tipologjisë së shtëpisë janë marrë parasysh edhe klasifikime me **karakter ekonomik**, që mban në themel të vet *veprimtarinë kryesore ekonomike të familjes: blegtorale, bujqësore etj. si edhe kriter me karakter shoqëror si: pozita ekonomike e familjes (e varfër, e pasur etj.); madhësia numerike e familjes, struktura e brendshme e saj: e vogël, e madhe, me shumë kurorë të martuara etj..* Pa mohuar të gjithë këta faktorë për përcaktimin e tipologjisë së ndërtimit të shtëpisë, sipas studiuesit Ali Muka, *“klasifikimi më i drejtë shkencor është ai që nisët nga zhvillimi planimetrik-vëllimor i banesës, i cili mundëson marrjen në konsideratë të cilitdo faktor tjetër, si plotësues në raport me të..... Ky kriter lehtëson vendosjen e dukurisë sipas një kronologjie relative, çka shmang çdo vështirësi të ngushtë teknik....., larmia e skemave në plan e në vëllim hedh dritë mbi shkallën e plotësimit të nevojave kryesore jetësore të familjes. Krijohen mundësi praktike për të ndjekur zhvillimin e banesës nga zgjidhja më e thjeshtë e në vazhdimësi”* (Muka 2010). Bazuar në zhvillimin planimetrik-vëllimor të banesës në këtë punim do të shqyrtojmë tre tipe shtëpish në trevën e Përmetit.

Metodologjia kërkimore

Për realizimin e këtij punim jam mbështetur në materialet arkivore dhe ato të dokumentuara si dhe në studimin e literaturës kritike antropologjike mbi fshatin mesdhetar si vendbanim të studiuesve të huaj dhe shqiptarë. Bashkëngjitur materialit të studiuar janë edhe gjetjet në terren gjatë ekspeditave në trevën e Përmetit e shtrirë në të dyja anët e lumit Vjosë e cila ndahet në gjashtë krahina etnografike.

Në këtë punim nuk kam ndërmend të sjell historinë apo evoluimin e ndërtimtarisë nga fillimi deri në ditët tona, sepse gjatë studimit tim në terren hasa në shumë vështirësi. Në fshatrat ku është bërë vëzhgimi gjendeshin territore të zbrazura me nga dy-shtatë familje dhe shtëpi të rrëzuara, ndërsa shtëpitë e reja në fshatrat pranë rrugës nuk i qëndrojnë mënyrës së ndërtimtarisë tradicionale. Duke u mbështetur në kujtesën e banorëve jam munduar të sjell sado pak një imazh mbi stilin e ndërtimit të shtëpisë tradicionale në këtë trevë.

Gjatë ekspeditave në fshatra e Përmetit, më ka tërhequr vëmendjen se për ndërtimin e shtëpisë pajtoheshin (merreshin si ndërtues) zanatçinj nga krahina të tjera të Shqipërisë. Ustallarët e Gollobor-dës ishin shumë të njohur si murator të zotë, por në trevën e Përmetit ndërtimi i shtëpisë i besohej ustallarëve të Oparit dhe të Koblarës. Ndërtimet nga muratorët e Koblarës i gjejmë të ndërtuara në fillim të shekullit XX, dhe banorët i identifikojnë me emrin, stili koblar. Ndërtimet e të dy siteleve ndryshojnë shumë nga njëra tjetra, si në planimetri edhe në elementët e përdorur arkitektonik.

Arkitektura e ndërtimeve

Në trevën e Përmetit dallohen tre lloje ndërtimi banesash, të cilat tregojnë për gjendjen ekonomike të familjes, por edhe të fshatit. Familjet që praktikuan kurbetin, krijuan një gjendje më të mirë ekono-

mike dhe patën mundësi për të ndërtuar shtëpi dy-tre katëshe me elementë arkitektonik të pasur. Karakteristike është se shtëpitë për nga materiali janë të ndërtuar me gurë. Çatia është e ndërtuar në formën e një trapezoidi jo shumë të lartë dhe me rrasa guri. Zakonisht shtëpitë janë të ndërtuara në mes të oborrit, dhe rrethohen dhe ndahen nga shtëpitë e tjera me mure guri. Mjedisi sanitar ndodhet jashtë shtëpisë, në fund të oborrit.

Tipi më i thjeshtë i ndërtimit ishte shtëpia e **tipit të banesës elbasanase**. Këtë tip e gjejmë shumë të përhapur në krahinën e Rrëzës dhe të Dëshnicës. Por edhe nga familje në gjendje jo shumë të mirë ekonomike në fshatra të ndryshëm të trevës. Kjo ndërtesë shërben për të gjitha funksionet e shtëpisë. Mjediset përbërëse të saj janë një korridor i gjatë sa gjerësia e banesës, që ndryshe quhej hajat. Në të dyja anët e hajatit janë dyert e dhomave: njëra quhet dhoma e zjarrit ose vatra dhe tjera dhoma e miqve. Dhoma e zjarrit shërben për të gatuar dhe për ngrohje gjatë netëve të dimrit. Dhoma e miqve shërben për fjetje. Brenda mjediseve të shtëpisë, në fund të hajatit, është e vendosur musandra.



Fshati Kosinë



Shtëpi e familjes Limonë në fshatin Lëshicë

Tipi i dytë i ndërtesës është **shtëpia qendrore** e ngritur nga toka gjysmë metri. Shtëpia qendrore kishte çati të madhe, me rrasa guri, ndërsa rreth saj janë të ndërtuara shtëpitë e vogla me çati më vete. Muret e jashtme të shtëpisë qendrore shërbenin si mure mbështetëse të shtëpive të vogla nga njëra anë. Këto pjesë janë shtuar më vonë me zgjerimin e familjes. Çdo ndarje krijonte një shtëpi të re ngjitur me atë qendroren. Kjo lloj arkitekture ishte shumë e përhapur në krahinën e Dëshnicës. Ato ishin të ndërtuara në bazë fisesh. Me ndarjen e vëllezërve, dhomat anësore të shtëpisë qendrore ktheheshin në shtëpi për familjen e ndarë nga trugu. Shtëpitë e çdo fisi janë të vendosura mbi kodër, larg njëra-tjetrës në një hapësirë 2-3 km.



Fshati Tolar

Shtëpia me dy kate tregon një nivel më të ngritur nga ana ekonomike për ata që e zotërojnë. Ky lloj ndërtimi paraqitet në dy forma arkitektonike në trevën e Përmetit. Njëra prej tyre njihet nga përmetarët si shtëpi e **tipit koblar**. Sipas tyre janë cilësuar kështu se ndërtoheshin nga mjeshtrit e fshatit Koblar. Kjo shtëpi dallohet për formën e saj drejtkëndëshe, dy katëshe. Nga brenda kati i parë i ngjan shtëpisë së tipit të banesës elbasanase, me hajat dhe dhoma në anët e saj, ndërsa në katin e dytë janë ngritur dhomat e fjetjes. Musandra është e vendosur në katin e dytë. Lidhja me katin e dytë bëhet me anë të shkallëve prej druri.



Shtëpia e Rrapollarëve në fshatin Odriçan (Cerje)

Për familjet që ishin më mirë nga gjendja ekonomike, dallohet një formë më e ndërlikuar në ndërtim përse i takon elementeve arkitektonikë. Për ndërtimin e këtij tipi shtëpish “pajtoheshin” ndërtues jashtë trevës së Përmetit, kryesisht nga krahina e Oparit të Korçës. Në ndërtimin e mjeshtrove oparotë vihen re elemente të pasur të arkitekturës qytetare, zanafilla e të cilave fillon që nga mesi i shekullit XIX. Këto elemente patën një ndikim të fuqishëm edhe në banesën fshatare të kësaj treve dhe bënë që fshatrat të kishin ngjashmëri me lagjet e qytetit.

Në fshatrat e krahinës së Shqerisë, Cerjes dhe Dangëllisë, ku ndryshimet në jetën ekonomike e shoqërore u ndjenë më shumë si rrjedhojë e kurbetit, gjetën shteg të favorshëm edhe përmirësimet në mënyrën e të jetuarit. Banesat në këto krahina janë të larta dy deri në tre kate. Zakonisht kati i parë shërbente si haur për kafshët e trasha dhe në një dhomë të veçantë, që quhej qilar, mbaheshin zahiretë e dimrit. Me kalimin e kohës, ky kat u kthye në mjedise të përdorimit të përditshëm. Në katin e dytë janë të vendosura dhomat e zjarrit dhe të fjetjes. Një dhomë e veçantë ishte oda e miqve.



Shtëpia e Begollarëve në fshatin Odriçan (Cerje)



Shtëpia e Cullufëve në fshatin Buhal, Monument Kulture

Oda e miqve, ishte dhoma më e mirë dhe më e zbukuruar e shtëpisë. Në traditën popullore ajo zë një vend të posaçëm, sepse lidhet me vlerësimin e veçantë që i bëhet mikut. Në rrethana të caktuara ekonomike- shoqërore, oda e miqve ka pësuar ndryshime të pandërprera në brendësi dhe në funksione. Zgjerimi ose ngushtimi i objekteve të zbukurimit, na bëjnë të njohur gjendjen ekonomike të një familjeje, ndërsa nga funksioni që kryejnë, shprehin pozitën shoqërore të familjes. Kjo për arsyen se odat nuk kanë luajtur vetëm funksionin e dhomave të argëtimit në festat familjare, por, megjithëse në mjediset fshatare kanë mbetur si kthinat e burrave, kanë shërbyer edhe si vende për muhabete e kuvende pleqsh, për lidhjet e miqësive e të krushqive, si spitale në raste luftërash dhe, në disa raste, edhe si mjedise mësimdhënieje. Përmendim këtu rastin, që na treguan në fshatin Odriçan, për Lukan Josifin, i cili, kur u dogj shkolla e fshatit, odën e shtëpisë së tij e ktheu në shkollë. Si rrjedhojë e funksioneve që ka marrë, oda e miqve, është dalluar nga dhomat e tjera të shtëpisë në shumë elemente si: nga madhësia, shkalla e mobilimit e zbukurimit.

Për pozicionin e saj nuk kishte ndonjë rregullsi të caktuar. Gjithmonë në ndërtesat dykatëshe parapëlqej kati i dytë. Sasia e numrit të njerëzve, që merrte oda, përcaktonte edhe statusin social të familjes. Kjo ishte dhoma më e zbukuruar e shtëpisë. Pasuria e elementeve të zbukurimit lidhej me mundësinë e pronarit të shtëpisë dhe, në vartësi të elementeve tradicionale të krahinave. Një element i veçantë ishte tavani, i cili zbukurohej me dru të gdhendur. Gjithashtu në këtë tip ndërtimi zë vend një platformë e ngritur gati gjysmë metri nga dyshemeja, vendi ku rrinte orkestra, ose sazet, si i quanin në Përmet⁶, në raste dasmash e gëzimesh. Për t'i bërë vend muzikës, përmetari mendonte që në kohën kur hidheshin themelet e ndërtesës.

Shtëpia e tipi kullë nuk është e njohur në trevën e Përmetit. Shtëpitë dykatëshe, që në katin e dytë kishin një dhomë me dritare nga të katër anët, në Përmet i quanin **kulë** dhe jo kullë. Me fjalën **kulë** kuptohej një ndërtesë me karakter thjesht mbrojtës dhe hapësirë pamjeje. Të tilla konsideroheshin ndërtesat që ishin me tre kate dhe në katin e sipërm kishin një dhomë me dritare nga të katër anët. Si e tillë është memorizuar në kujtesë banesa e Milkë Avam Lipës. Ndërsa në fshat **kulë** quheshin edhe disa shtëpi të vogla të ndërtuar me dërrasa në mes të arës, në një lartësi gati 2 metra nga toka, që shërbente si pikë vrojtimi.

Banesat e vjetra për nga materiali dallohen për ndërtimin me gur dhe rrasa guri, në vitet e pas Luftës II Botërore ndërtimet, që u bënë në fshat, si shkolla, zyrat e administratës së kooperativës, vatrat e kulturës, qendrat shëndetësore janë ndërtuar me tulla. Pas viteve 1990, banesat e ndërtuara kanë pamje më moderne dhe shpesh për to përdoret emërtimi vilë. Për ndërtimin e tyre përdoren beton, tulla, ndërsa çatia mbulohet me tjegulla. Ka edhe raste kur shtëpia nuk ka çatë, por mbulohet me tavan prej betoni që shërben si verandë. Mjediset sanitare përfshihen brenda ndërtesës në ndarje të veçantë.

⁶ Ndryshe quhej edhe vendi i shahireve

Konkluzione

Larmishmëria e madhe për nga gjinitë e trashëgimisë ndërtimore në trojet shqiptare mbartin tipare individuale me vlera kulturore e rëndësi studimore. Ndërtimtaria tradicionale shqiptare është karakterizuar nga bashkëveprimi i ndërsjellët mes porositësit dhe ndërtuesit që rrjedh nga mungesa e një projekti të mëparshëm të hedhur në letër, si dhe kalimi i përvojës nga një brez në tjetrin.

Shtëpia si një pjesë e jetës së njeriut dhe e pandarë nga ushqimi dhe veshja në kultura të ndryshme lidhet me banesën si koncept material dhe me baza shpirtërore ku zhvillohen rituale. Ndër shqiptarë shtëpia identifikon familjen por merr edhe kuptim material si objekt fizik që shërben për t'u strehuar anëtarët e saj. Sot koncepti shtëpi merr më tepër kuptimin e një ndërtese të trashëguar, blerë, apo ndërtuar.

Përcaktimi dhe klasifikimi tipologjik i shtëpisë tradicionale ndër shqiptarë bazohet në faktor gjeografikë, materialo-teknikë, mbulesa e **çatisë, planimetria**, mënyra e ndarjes së ambienteve, numri i kthinave, lartësia, madhësia e familjes. Gjithashtu rol të veçantë luajnë edhe kriteret me karakter ekonomik (shtëpi bujqësore a blegtorale) dhe shoqëror (e pasur, e mesme, e varfër).

Në **trevën e Përmetit** në tipologjinë e ndërtimi të shtëpisë tradicionale, që deri diku vihet re edhe në ndërtimet e reja, të gjithë tipat e shtëpive janë klasifikuar si *shtëpi guri* nga materiali i përdorur për ndërtimin e mureve dhe mbulesës së çatisë. Gjendja ekonomike e familjeve që ndoqën kurbetin krijoi mundësinë e ndërtimit të shtëpive me elemente arkitektonik më të zhvilluar të cilat u njohën si shtëpi me kate dhe qemer. Ndërtimi i shtëpive të këtij tipi solli gjithashtu edhe një diferencim mes fshatrave nga krahina në krahinë e trevës së Përmetit. Shtëpia e tipit koblarë me planimetrinë e saj drejtkëndëshe, në formë L dhe U, u klasifikuan sipas emrit të mjeshtrave murator që i ndërtuan.

Si përfundim ndërtimtaria së bashku me ushqimin dhe veshjen është bashkudhëtari i njeriut dhe pjesë e mënyrës së jetesës që mbart dëshmi historike dhe përbën një ndër treguesit kulturor duke luajtur një rol të pashmangshëm në përcaktimin se kush jemi.

Referenca

- Bardhoshi, N. (2011) *Gurtë e Kufinit*, UET Press, Tiranë
- (2013) *Fisi përmes përfytyrimeve antropologjike dhejetës së përditëshme: një antropologji kritike e fisit në Shqipërinë e Veriut*, Kultura Popullore, QSA, IAKSA, Tiranë, f.75-101.
- Bourdieu, P. (1979) *"The Kayble house or the world reversed."* Pp. 133–155 in *Algeria 1960*, translated by R. Nice. Cambridge: Cambridge University Press.
- Canolli, A. (2018) *Një përshkrim antropologjik i shtëpisë*, Gazeta Koha, 5 Tetor, online.
- Frashëri, Gj. *Fshati Historik i Odriçanit*, Shtëpia Muye dhe Monumente Kulture. 8 Nëntori, Tiranë, f.10-20
- Humphrey, C. (1988) *No Place Like Home in Anthropology: The Neglect of Architecture*, Anthropology Today, Vol. 4, No. 1, p. 16-18. Published By: Royal Anthropological Institute of Great Britain and Ireland.
- Krasniqi, M. (1979) *Gjurmë e gjurmime*, 8 Nëntori, Tiranë.
- Levi-Strauss, C. (1983) *The way of the masks*. London: Jonathan Cape.
- Moore, J. D.. (2012) *The Prehistory of Home*. University of California Press
- Morgan, L.H. (1978) *Ancient society*. New York: Labor Press
- (1981) [1881]. *Houses and house-life of the American aborigines*. Chicago: University Press
- Muka, A. 2001, *Banesa fshatre dhe familja e madhe*, monografi, Tiranë.
- (2010) *Ndërtimet Tradicinale Shqiptare si objekt studimi etnologjik*, AKTET, Vol. III, Nr.4, f. 510-518.

Riza, E. & Halili, Nj. (2008), *Banesa qytetare kosovare e shekujve XVII-XIX*, Prishtinë.

Samanani, F. & Lenhard, J, (2019). *House and home*, The Cambridge Encyclopedia of Anthropology.

Thomo, P. (1981), *Aspekte të njësisë dhe të larmisë në arkitekturën tone popullore*, Kultura Popullore¹, Tiranë

Zojzi, Rr. (1962) *Ndamja krahinore e popullit shqiptarë*, Etnografia Shqiptare 1, Tiranë